



HOPE FOR THE WORLD ALBANIA
FONDACIONI 'SHPRESË PËR BOTËN'
SHKODËR, ALBANIA

Nr. 5 Prot.
Shkodër, më 12.01.2026

Nr. 2 Prot.
Shkodër, më 12.01.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në Shkodër, me datë 12/01/2026 ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Shtëpisë Familje për të Rinj 16-18 vjeç, me NIPT K56704020N me Drejtore znj. **Valbona TULA**, mbajtëse e kartës së identitetit me nr.letërnjoftimi 035484296 , nr.personal H05316131D, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rr. Marin Biçikemi, Shkodër, këtej e tutje e cilësuar si **"Shtëpia Familje për të Rinj 16-18 vjeç"**.

dhe

Fondacionit "Hope for the World", regjistruar sipas Vendimit të Gjykatës nr.174, dt. 04.01.1996, me nr. NIPT J62214001L, si dhe me një Liçensë nga QKL për "Shërbim të Përkujdesit të Rezidencial " LN-2747-01-2011, përfaqësuar nga z. **Alfred ZEFI**, mbajtës i kartës së identitetit me nr.letërnjoftimi 032318024, nr.personal H70412127B në cilësinë e drejtorit, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, adresa: Rr. "Kuklej", Shkodër.

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet **për përmirësimin e cilësisë dhe pasurimin e gamës së shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së të rinjve.**

në përputhje me :

- Ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurese" i ndryshuar;
- Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- V.K.M nr. 658 datë 17.10.2005 "Për standartet e shërbimeve shoqërore";
- Ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat e mbrojtjes së fëmijës";
- Vendimin nr. 89, datë 26. 01. 2012 " Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë", udhëzimit nr. 11, datë 09. 03. 2015 " Mbi zbatimin e VKM-së nr. 89" dhe

- Udhëzimin nr. 10, datë 25.02.2015 “Për mënyrat, format, e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.

Palët e mësipërme bien dakort për lidhjen e kësaj marrëveshjeje vijon si më poshtë:

NENI 1

Palët në Marrëveshje

- **Fondacioni “Hope for the World”**.Fondacioni “Shpresë për Botën” është një OJF me karakter humanitar që vepron në favor të fëmijëve në Shqipëri,e regjistruar në Drejtorinë e Tatim-Taksave me nr.NIPT-i **J62214001L** në datën 07.12.2010 si dhe me një licensë nga QKL për “Shërbim të Përkujdesit të Rezidencial ” **LN-2747-01-2011**.me adresë: Marikaj-Vorë, përfaqësuar me prokurë nga **Z.Alfred ZEFL**.

- **Shtëpi Familje për të Rinj 16-18 vjeç**,me nr.NIPT-i **K56704020N** me Drejtore znj.**Valbona TULA** , madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rr. Marin Biçikemi, Shkodër .

NENI 2

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është të përcaktojë angazhimet e ndërsjella të palëve për **përmirësimin e shërbimeve të kujdesit dhe mbrojtjes për përfituesit e Shtëpisë së të Rinjve**, bazuar në standartet e shërbimeve shoqërore për të garantuar interesin më të lartë të tyre.

NENI 3

Angazhimet e palëve

3.1 Fondacioni “ Hope for the World” merr përsipër:

Nëpërmjet përfaqësuesit vendor të tij:

a.Të bashkëpunojë me Shtëpinë Familje për të Rinj 16-18 vjeç,Shkodër për të organizuar aktivitetet për kremtimin e festave ndërvjetore.

b.Të bashkëpunojë me Shtëpinë Familje për të Rinj 16-18 vjeç,Shkodër për të organizuar festimin e ditëlindjeve dhe blerjen e dhuratave.

c.Të mbështesë Shtëpinë Familje për të Rinj 16-18 vjeç,Shkodër për shërbime mirëmbajtjeje të ambjenteve.

d. Të mbështesë financiarisht transportin për vizitat e koordinuara të familjarëve të të rinjve pranë Qendrës.

- e. Të kontribojë për aktivitete të të Rinjve jashtë qendrës së tyre të përhershme.
- f. Të mbështesë financiarisht për kurse arti e sporti të të rinjve të Qendrës.

3.2 Shtëpia Familje për të Rinj 16-18 vjeç merr përsipër:

- a. Të jetë disponibël me përfaqësuesit e fondacionit për të mundësuar operimin sa më funksional të veprimtarisë së tyre në funksion të edukimit dhe mirërritjes së të rinjve në përputhje me standartet e shërbimeve shoqërore.
- b. Të lejojë vizitat miqësore të individëve apo grupeve të ndryshme të organizuar nga fondacioni "Hope for the World", të cilët duan të vizitojnë institucionin apo duan të kontribojnë në ndihmë të institucionit, duke respektuar Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së me nr. 1831 prot, datë 03.09.2014. "Për plotësimin e deklaratës nga personat e tretë që hyjnë në institucionet e perkujdesit shoqërorë për fëmijë" deklaratën e vizitorit.
- c. Të vendosë në ambjentet e institucionit stenda me fotografi dhe materiale të aktiviteteve të zhvilluara në bashkëpunim me fondacionin.
- ç. Të vërë në dispozicion të zhvillimit të aktiviteteve ambjente të caktuara të institucionit.
- d. Të sigurojë ambjente pune për punonjësit e fondacionit që do të bëjnë punë vullnetare në Shtëpinë Familje të të Rinjve.

NENI 4

Kohëzgjatje e marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi shtrihet përgjatë një periudhe nga data e nënshkrimit të saj deri me **31 Dhjetor 2026**.

NENI 5

Zbatimi i marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnerë në koordinimin e të gjitha nismave që do të garantojnë mundësimin e shërbimeve sa më cilësore për fëmijët. Kësaj marrëveshje i bashkëngjitet **Plani i Aktiviteteve** i cili do të realizohet nga palët menjëherë pas nënshkrimit.

NENI 6

Përfundimi i marrëveshjes

6.1 Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- a. mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje
- b. shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes

c. palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes

6.2 Secila nga palët duhet të njoftojë palët e tjera me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje;

6.3 Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim.

NENI 8

Dispozita të fundit

8.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnerë në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive.

8.2 Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

1. PLANI I AKTIVITETEVE PËR PERIUDHËN 13.01.2024-31.12.2025

Nr.	Aktiviteti	Vlera për çdo aktivitet
1.	Mbështetje për aktivitete dhe për kremtimin e festave vjetore.	\$ 800
2.	Mbështetja për organizimin dhe kremtimin e ditëlindjeve. Organizimi i festës dhe përgatitja e dhuratave për të rinjtë që kanë ditëlindjen.	\$ 400
3.	Shërbime dhe mirëmbajtje të ambjenteve	\$ 1350
4.	Mbështetje për transportin e familjarëve të të rinjve për vizitat e planifikuara	\$ 250
5.	Mbështetje për kurse arti e sporti	\$1000
6.	Mbështetje për aktivitete brenda dhe jashtë institucionit	\$1200

2. MBËSHTETJA FINANCIARE



Kontributet për mbështetjen financiare të aktiviteteve të mësipërme do të jenë të ndryshme për çdo muaj. Shpenzimet e përgjithshme vjetore që do të mbështesë Fondacioni për Shtëpine e të Rinjve do të jenë \$5000 (pesëmijë dollarë)

3. VAZHDIMËSIA E MBËSHTETJES SË PROJEKTEVE

Brenda muajit Maj 2026, Drejtoria e Shtëpisë së të Rinjve mund të paraqesë pranë Fondacionit Hope for the World, kërkesat për ndryshimin e llojeve të aktiviteteve, për ti përfshire si aktivitete te mundshme në hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për vitin 2027.

Miratoi:

PËR

Shtëpi Familje për të Rinj 16-18 vjeç

Drejtores

Valbona TULA



PËR

Fondacionin Hope for the World

Drejtor

Alfred ZEFI

